

VENDIM
Nr. 148, datë 20.3.2019

**PËR PROCEDURËN QË ZBATON SHËRBIMI I PROVËS NË RAST TË
MOSPËRMBUSHJES SË MASËS ALTERNATIVE TË SHMANGIES NGA NDJEKJA
PENALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 10, të nenit 72, të ligjit nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i procedurës që zbatohet nga Shërbimi i Provës në rastet e mospërmbushjes së kushteve dhe detyrimeve që burojnë prej masës alternative të shmangies nga ndjekja penale e të miturit.

2. Shërbimi i Provës, në ushtrimin e veprimtarisë së tij, udhëhiqet nga parimi i interesit më të lartë të miturit dhe masa alternative e shmangies nga ndjekja penale u shërben më mirë qëllimeve të rishoqërizimit, rehabilitimit të të miturit dhe parandalimit të shkeljeve të ligjit përkundrejt vendosjes së tij nën përgjegjësinë penale dhe zbatimit të dënimit penal.

3. Kompetencat e Shërbimit të Provës, në rast mospërmbushjeje të kushteve dhe detyrimeve që burojnë prej masës së shmangies nga ndjekja penale për të miturit, janë, si më poshtë vijon:

a) ndjek dhe mbikëqyr detyrimet që rrjedhin nga masa e shmangies, si organ kompetent që zbaton edhe procedurën e përcaktuar në këtë vendim, për mospërmbushjen e masës alternative të shmangies nga ndjekja penale e të miturit;

b) informon menjëherë me shkrim prokurorin, duke i vënë në dispozicion raportin e vlerësimit, sipas pikës 5 të këtij vendimi, i cili ka dhënë vendimin e masës së shmangies nga ndjekja penale për të miturin lidhur me kohën, vendin, mënyrën dhe rrethanat e mospërmbushjes së masës së shmangies, si dhe situatën personale të të miturit, vlerësuar në përputhje me pikat 1 e 2, të nenit 22, të ligjit nr. 37/2017, dhe të japë mendimin e tij.

c) informon menjëherë me shkrim të miturin me masën alternative të shmangies nga ndjekja penale, prindërit ose, sipas rastit, kujdestarin/ përfaqësuesin ligjor lidhur me pasojat e moszbatimit të kushteve dhe detyrimeve të masës së shmangies dhe rregullat e shqyrtimit në rast mospërmbushjeje.

4. Në rastet kur Shërbimi i Provës konstaton se i mituri nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga masa alternative e shmangies nga ndjekja penale, merr masat, si më poshtë vijon:

a) verifikon faktet dhe rrethanat që ndikojnë në mospërmbushjen prej të miturit të detyrimeve nga masa alternative e shmangies nga ndjekja penale;

b) fton të miturin, prindërit e tij ose kujdestarin/ përfaqësuesin ligjor në takim, me qëllim diskutimin e rrethanave të mospërmbushjes së detyrimeve që burojnë nga masa alternative e shmangies, i cili mbahet brenda 3 (tri) ditëve nga data e dërgimit dhe njoftimit të ftesës për takim. Në njoftim tregohet vendi, data dhe ora e takimit, emri i punonjësit të Shërbimit të Provës, si dhe numri i telefonit dhe adresa e Shërbimit të Provës. Njoftimi kryhet me mjete teknike të përshtatshme që garantojnë njoftimin, si: telefoni, telegrafi, telegrami, faksi apo posta elektronike. Njoftimi ka vlerë kur i mituri dhe prindërit e tij konfirmojnë marrjen e tij;

c) kur, për arsye objektive, i mituri dhe prindërit ose kujdestari/përfaqësuesi ligjor nuk mund të jetë i pranishëm në takim, ai njofton paraprakisht punonjësin e Shërbimit të Provës, duke parashtruar arsyet e mungesës. Në këtë rast punonjësi i Shërbimit të Provës cakton një takim të dytë, jo më vonë se 4 (katër) ditë nga takimi i parë. Në rast se i mituri dhe prindërit e tij ose kujdestari/ përfaqësuesi ligjor nuk paraqiten edhe në takimin e dytë, atëherë punonjësi i Shërbimit të Provës njofton menjëherë prokurorin;

ç) mbajtjen e procesverbalit, i cili përshkuan në mënyrë të hollësishme shkaqet e mbajtjes së tij,

tregimin e fakteve dhe rrethanave që Shërbimi i Provës ka për mospërmbyshjen e masës alternative të shmangies nga ndjekja penale nga i mituri dhe prapësimet e bëra nga i mituri, prindërit ose kujdestari/përfaqësuesi ligjor dhe evidentimin e pranisë së psikologut. Procesverbal i nënshkruhet nga të gjitha palët pjesëmarrëse në takim, përfshirë edhe psikologun.

5. Brenda 5 (pesë) ditëve nga zhvillimi i takimit, punonjësi i Shërbimit të Provës ka detyrimin të kryejë të gjitha verifikimet e mundshme të shkaqeve dhe rrethanave të mospërmbyshjes së detyrimeve që burojnë nga masa alternative e shmangies nga ndjekja penale për të miturin dhe, mbi këtë bazë, harton raportin e vlerësimit. Raporti i vlerësimit përmban:

a) urdhrin e lëshuar nga organi procedues për masën alternative të shmangies nga ndjekja penale dhe kopje të marrëveshjes me detyrimet përkatëse, që janë urdhëruar për t'u përmbushur nga i mituri;

b) kohën, vendin dhe rrethanat e mospërmbyshjes së detyrimit të masës alternative për shmangie nga ndjekja penale e të miturit, përshkrimin dhe analizën e të miturit, duke përfshirë informacionin për gjendjen e tij sociale, historinë personale, arsimimin, punësimin apo trajnimet, strehimin, shëndetin fizik apo mendor, vështirësitë personale, gjendjen financiare, qëndrime të përgjithshme shoqërore dhe çdo faktor tjetër që punonjësi i Shërbimit të Provës e konsideron të rëndësishëm;

c) përmbledhje të të gjithë informacionit dhe fakteve të rastit të paraqitura në formën e një analize për shkakun e mospërmbyshjes së detyrimeve të masës alternative të shmangies nga ndjekja penale e të miturit;

ç) analizën, nëse kjo shmangie e këtyre detyrimeve është kryer me apo pa qëllim nga ana e të miturit;

d) burimet e informacionit të përdorura për të përgatitur raportin, duke përfshirë personat e intervistuar dhe dokumentet e konsultuara;

dh) përfundimet dhe rekomandimet e Shërbimit të Provës për prokurorin, në referim të pikës 1, të nenit 71, të ligjit nr. 37/2017.

6. Kundër veprimeve të punonjësit të Shërbimit të Provës të caktuar me mbikëqyrjen e masës alternative të shmangies nga ndjekja penale, i mituri, prindërit ose kujdestari /përfaqësuesi ligjor i tij ka të drejtën e ankimit tek eprori i punonjësit ose te prokurori i çështjes që ka caktuar masën alternative të shmangies.

7. Raporti i vlerësimit për mospërmbyshjen e masës alternative të shmangies nga ndjekja penale e të miturit përpilohet sipas modeleve të miratuara nga ministri i Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.

8. Raportit të vlerësimit për mospërmbyshjen e masës alternative të shmangies nga ndjekja penale nga i mituri i bashkëlidhet edhe kopje e procesverbalit të mbajtur sipas pikës 4, të këtij vendimi, dhe çdo dokument apo e dhënë tjetër që punonjësi i Shërbimit të Provës e gjykon të nevojshme.

9. Nëse i mituri, për të cilin është kërkuar raporti i vlerësimit për mospërmbyshjen e masës alternative të shmangies nga ndjekja penale, nuk bashkëpunon, punonjësi i Shërbimit të Provës e përmend refuzimin e bashkëpunimit në raportin e vlerësimit.

10. Kopja e raportit të vlerësimit për mospërmbyshjen e masës së alternative të shmangies nga ndjekja penale u dërgohet edhe të miturit, prindërve ose kujdestarit/përfaqësuesit ligjor të të miturit.

11. Të dhënat për të miturin, që nuk përmbush masën alternative të shmangies nga ndjekja penale, mbahen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

12. Të dhënat për procedurën e ndjekur për mospërmbyshjen nga ana e të miturit të masës alternative të shmangies nga ndjekja penale mund t'u jepen ministrit të Drejtësisë, drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës, të miturit, prindërve të tij, kujdestarit/përfaqësuesit ligjor, në përputhje me legjislacionin në fuqi për klasifikimin e akteve dhe për mbrojtjen e të dhënave personale.

13. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Erion Braçe